

**Komisioni i Disiplinës**  
**VENDIM**  
**Nr. 5**

Nr. 89 Prot.

6 Nëntor 2024

Më datë 4 nëntor 2024 u mbledh Komisioni i Disiplinës i Federatës Shqiptare të Basketbollit, nën drejtimin e kryetarit, z. Klevis Kaso, me praninë e anëtarëve, z. Franko Bushati dhe z. Klaudio Ndoja, për trajtimin e problematikës së hasur pas ndeshjes, Besëlidhja vs Teuta, datë 3 nëntor 2024, ndeshje e vlefshme për javën e IV-rt të Superligës Meshkuj.

Në relacionin e gjyqtarit kryesor të ndeshjes paraqitet sjellje josportive e lojtarit Vinsent Grazhdani ndaj gjyqtarit Fatjon Malevi, me fyerje dhe kërcënime, duke krijuar një situatë në limitet e konfrontimit fizik.

Për sa më sipër, Komisioni i Disiplinës, pasi trajtoi materialet përkatëse për shqyrtim, duke marrë në konsideratë relacionin e Vëzhguesit bazuar në nenin 16.8, të rregullores së aktiviteteve kombëtare të basketbollit,

**Vendosi:**

1. Sanksion financiar në vlerën 10'000 lek për lojtarin Vinsent Grazhdani, bazuar në rregulloren e aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 14.9, *“Sjellje josportive e lojtarëve, trajnerëve apo personave të tjerë që qëndrojnë në stol (fyerje, kërcënime, etj) të cilat nuk janë ndëshkuar nga gjyqtaret gjatë ndeshjes si edhe pas përfundimit të saj, por paraqiten nga vëzhguesi”*.
2. Tërheqje vëmendje për lojtarin Vinsent Grazhdani, në rast të sjelljes së përsëritur josportive, do të ketë masa disiplinore të përshkallëzuara.

Në bazë të rregullores së aktiviteteve kombëtare të basketbollit, neni 11.8, *“Kundër vendimit të komisionit të disiplinës, mund të apelohe brenda 72 orëve nga marrja e vendimit. Apeli duhet të adresohet pranë Komisionit të Apelit në FSHB dhe duhet të jetë i shoqëruar me vërtetimin e pagesës së shumës 10'000 në arkën e FSHB-së. Një kopje e kërkesës së apelit i dërgohet palëve. Komisioni i apelit trajton dhe shqyrton çdo vendim që është marrë nga komisioni i disiplinës dhe kontestohet nga palët e përfshira në vendim. Vendimet e Komisionit të Apelit mund të ankimohen në KAS, (Këshilli i Arbitrazhit Sportiv).”*



**Klevis Kaso**  
Kryetar



**Franko Bushati**  
Anëtar



**Klaudio Ndoja**  
Anëtar